



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

CSR

Bankat për Shoqërinë

20
21



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

8 VJET RAPORT CSR

BANKAT PËR SHOQËRINË



PARATHËNIE

I nderuar Lexues!

Për bankat jemi mësuar të dëgjojmë për rritjen e kreditimit, për depozitat, për fitimin, por më rrallë jemi mësuar të dëgjojmë për pjesën tjetër të veprimtarisë së tyre – atë jo tregtare dhe që ka të bëjë me përgjegjësinë sociale të korporatave dhe, më tepër akoma, për kontributin dhe drejtimin e veprimtarisë bankare drejt Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Ne jemi krenarë që kemi mundur në vite të zhvillojmë politikën tonë të Përgjegjësisë Sociale të Korporatave dhe të gjendemi pranë shtresave në nevojë, komuniteteve të ndryshme, sektorëve të ndryshëm, aspekteve sociale, artistike dhe sportive duke kontribuar financiarisht për zhvillim të mëtejshëm. Janë rreth 330 milionë lekë të shpenzuara nga bankat gjatë vitit 2021 për këto qëllime!

Nga ana tjetër, përshtatja e veprimtarisë bankare drejt zhvillimit të qëndrueshëm dhe mbrojtjes së ambientit, në kuadër të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, është një karakteristikë dalluese e dekadës së tretë të këtij shekulli, ku të gjitha korporatat dhe bizneset e mëdha kanë përqafuar këto zhvillime dhe janë shtysa kryesore e mbrojtjes së ambientit nga ndryshimet klimaterike. Sektori bankar në Shqipëri është nga sektorët pararojë të ekonomisë për dhënien e shembullit mes arritjeve konkrete gjatë vitit 2021:

- Mbi 22 miliardë lekë hua për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme;
- Mbi 14 miliardë lekë hua për shtëpi eficiente;
- Rreth 14 miliardë lekë hua për energji të rinovueshme;
- Mbi 3 miliardë lekë për biznese që drejtohen nga gjinia femërore;
- Rreth 10 miliardë lekë hua për agroturizmin dhe turizmin;
- Rreth 3 miliardë lekë për agrobizneset.



Industria bankare në vetvete ka të punësuar rreth 54% gjini femërore. Rreth 27% e pozicioneve drejtuese i përkasin gjinisë femërore.

Nëse ju nevojitet me shumë informacion, ju ftoj me shumë kënaqësi të shfletoni këtë botim të AAB-së. Jam i sigurt që do të gjeni shumë të dhëna interesante, shembuj nga gjithë vendi dhe ndoshta diku mund të jeni edhe vetë protagonist!

Ju uroj lexim të këndshëm!

Me respekt,

Bledar SHELLA

KRYETAR,
Shoqata Shqiptare e Bankave
DREJTOR I PËRGJITHSHËM,
OTP Bank Albania

Përmbajtja

OBJEKTIVI 1	Pa Varfëri	6
OBJEKTIVI 2	Zero Uri	8
OBJEKTIVI 3	Shëndeti i Mirë dhe Mirëqënie	11
OBJEKTIVI 4	Arsim Cilësor	16
OBJEKTIVI 5	Barazi Gjinore	22
OBJEKTIVI 7	Energji e Përbalueshme	25
OBJEKTIVI 8	Punë Dinjitoze dhe Rritje Ekonomike	27
OBJEKTIVI 9	Industri, Inovacion dhe Infrastrukturë	29
OBJEKTIVI 10	Zvogëlim i Pabarazive	31
OBJEKTIVI 11	Qytete dhe Komunitete të Qëndrueshme	33
OBJEKTIVI 12	Konsum dhe Prodhim i Përgjegjshëm	35
OBJEKTIVI 13	Veprim për Klimën	36
OBJEKTIVI 14	Jeta nën Ujë	38
OBJEKTIVI 15	Jeta në Stere	39
OBJEKTIVI 17	Partneritet për Objektivat	40
ART, SPORT & KULTURË	42

OBJEKTIVAT PËR NJË ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM



OBJEKTIVI #1 Pa Varfëri

69 përqind e popullsisë në moshë kanë llogari bankare.

Rreth **145** milionë lekë kontribut nga bankat në mbështetje të institucioneve dhe komunitetit.

MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

- Ofron inovacione për zhvillimin e produkteve të reja bankare, metodologjitë për vlerësimin e kredive, modellet e operimit dhe kanalet e shpërndarjes (duke përfshirë mobile banking) për përmirësimin e përfshirjes financiare, duke përfshirë edhe bankingun për 2.5 miliardë njerëz të rritur që aktualisht nuk disponojnë llogari bankare, si dhe sigurimin në nivel mikro për rritjen e mbrojtjes sociale.
- Siguron për të gjithë burrat dhe gratë, veçanërisht të varfrit dhe personat e cenueshëm që të kenë të drejta të barabarta në burimet ekonomike, si dhe qasje në shërbimet bazë, të gëzojnë pronësinë dhe kontrollin mbi tokën dhe formave të tjera të pronës, trashëgiminë, burimet natyrore, teknologjitë e reja të përshtatshme dhe shërbimet financiare, duke përfshirë edhe mikro-financën.

NUK KA MË JUSTIFIKIME PËR TË MOS PASUR NJË MAKINË ELEKTRIKE

Kariko makinat falas në rrjetin tonë

KUJDESU PËR PLANETIN, NJËSOJ SI PËR MAKINËN!



DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

Credins Bank prej vitesh ka ndjekur strategjinë e ofrimit të kushteve preferenciale apo produkteve pa komision me qëllim përfshirjen financiare dhe njohjen me produktet bankare. Për shtresat në nevojë ofrohen llogari rrjedhëse pa komision aplikimi, për studentët ofrohen llogari pa komision për kalimin e bursave, për pensionistët ofrohet llogari për tërheqjen e pensionit pa komision mirëmbajtje, ndërkohë që për të gjithë klientët që kanë llogari page ofrohen paketat e produkteve të kombinuara, në të cilat përfshihen shërbimet e kartës së debitit dhe e-banking me qëllim edukimin e klientëve në përdorimin e këtyre produkteve dhe minimizimin e përdorimit të cash-it në ekonomi.

Gjatë vitit 2021, rreth 30 % e paga marrësve të bankës kanë përzgjedhur të përfshihen në paketat e pagave. Në muajin mars, Credins Bank ofroi karta krediti pa komision aplikimi dhe mirëmbajtje për të gjithë klientët e gjinisë femërore. Gjatë këtij muaji 80 % e aplikimeve për karta krediti kanë qenë nga klientë të gjinisë femërore.

Intesa Sanpaolo Bank Albania publikoi së brendshmi për të gjithë punonjësit e bankës “Rregullat mbi diversitetin për orientimin dhe identitetin seksual” dhe “Rregullat për luftimin e ngacmimit seksual”.

PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

Në prag të festave të fund vitit, **Banka Amerikane e Investimeve** i është bashkuar nismës “Këpucët e Krishtlindjes”, ndërmarrë nga Fondacioni Çelësi Im. U dhuruan 100 palë këpucë për fëmijë të familjeve në nevojë, në zona të thella të qyteteve Shkodër, Korçë dhe Lushnjë.

Stafi i **ProCredit Bank**, në mënyrë vullnetare, ka mundësuar organizimin e festës së fundvitit për fëmijët e Qendrës Komunitare në Shkozë. U dhuruan libra për t'u përdorur gjatë trajnimeve dhe terapive që bëhen në këtë qendër.

Tirana Bank

- Falë kontributit të bankës, familja Rama nga Spiteni i Lezhës u rikthye të banojë në një strehë të sigurt në qytet. Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Tirana Bank, z. Dritan Mustafa dhe Drejtori i Përgjithshëm i Entit Kombëtar të Banesave, z. Stefan Çipa, ishin të pranishëm në qytetin e Lezhës për të bërë dorëzimin apartamentit.
- Motrat Çokaj jetonin në një shtëpi të rrënuar në Grudë Fushë të Malësisë së Madhe. Mungesa e kushteve minimale të jetesës ndikuan drejtpërdrejt në përkeqësimin e shëndetit të tyre. Tashmë familja Çokaj është vendosur në një apartament në qytetin e Shkodrës. Shtëpia e rinovuar ndodhet pranë spitalit të qytetit, në mënyrë që zonjat të marrin lehtësisht shërbimin mjekësor. Dhurimi u mundësua nga Tirana Bank, pjesë e BALFIN Grup.



OBJEKTIVI #2 Zero Uri

Financim i agro bizneseve: **641** kredi të reja të dhëna gjatë vitit në vlerën **2.75** miliardë lekë.

Teprica e kredisë në fund të vitit 2021: **4.23** miliardë lekë.

Mbi **50** marrëveshje të reja të nënshkruara me institucione për rritjen e financimeve për një bujqësi të qëndrueshme në vlerë mbi **380** milionë lekë.

Rreth **1.4** milionë lekë kontribut nga bankat në mbështetje të institucioneve dhe komunitetit.

MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

- Bashkëpunim me Qeverinë dhe institucionet financiare për rritjen e financimeve për një bujqësi të qëndrueshme.
- Bashkëpunim me shoqëri të tjera, Qeverinë dhe shoqërinë civile për identifikimin e mundësive të reja të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse të biznesit (p.sh., financimi i farës dhe risive në mikro-ushqyerje).
- Sigurimi i qasjes për të gjithë njerëzit, në veçanti për të varfrit dhe njerëzit në situata të cenueshme, duke përfshirë edhe foshnjat, në ushqime të sigurta, ushqyese dhe të mjaftueshme gjatë gjithë vitit.





DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

Bankat (Credins Bank, Raiffeisen Bank Albania, Union Bank) janë të fokusuara në aktivitete huadhënie për zhvillimin e bujqësisë dhe bashkëpunojnë me qeverinë dhe institucione financiare, si: Albanian Development Guarantee Foundation (ADGF), BERZH, etj., për rritjen e financimit për një bujqësi të qëndrueshme.

Credins Bank

- Gjatë vitit 2021 vijoi bashkëpunimin me Rural Credit Guarantee Foundation (RCGF) me produktin Post Covid, fond i cili mbështet klientët kryesisht në sektorin e bujqësisë, edhe në rastin kur nuk plotësohen kushtet e mbulimit me kolateral.
- Me bankën lëvizëse është mundësua prezenca në zona të ndryshme rurale duke promovuar produktet bankare.
- Mori pjesë në panairin “Shqipëria Punon tokën” dhe “Panairi i Shalqinit dhe Pjepit”, panire me produkte shqiptare e me fermerë nga i gjithë vendi duke treguar mbështetje ndaj prodhimeve dhe produkteve vendase si dhe informuar mbi produktet e kredisë Agro.

Raiffeisen Bank Albania dhe Rural Credit Guarantee Foundation (RCGF) nënshkruan një marrëveshje garancie për të mbështetur Biznesin Mikro në Shqipëri në vlerë prej 5 milionë euro, e cila synon të lehtësojë financimin për biznesin mikro në Shqipëri në formën e Instrumentit Individual të Garancisë për kreditë dhe përfituesit e kualifikuar.

Banka ProCredit ofron për të gjithë klientët e saj individë një version të ri të aplikacionit m-banking. Përmes tij, çdo përdorues mund të kryejë pagesën e faturave shpejt dhe sigurt duke skanuar faturat, ofrohet edhe mundësi për bllokim dhe zhbllokim kartash, apo rritje limiti direkt nga aplikacioni pa pasur nevojë për të kontaktuar bankën.



PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

Nismat për të mbështetur familjet në nevojë me pako ushqimore, si dhe organizimi i aktiviteteve festive në fund të vitit për fëmijët e familjeve në nevojë / jetimë, vazhdojnë të mbetet prioritet i bankave.

Alpha Bank Albania, Banka Amerikane të Investimeve, Credins Bank dhe **Tirana Bank** bashkëpunuan me Food Bank Albania dhe Kryqin e Kuq Shqiptar në ndihmë të familjeve në vështirësi ekonomike.

Credins Bank vazhdon me mbështetjen financiare të dy fëmijëve të SOS Fshatrat e Fëmijëve, duke i ndihmuar në arsim, mirëqenie si dhe aktivizim social.

“Kujdesemi me Zemër” është iniciativa e përvitshme që **Raiffeisen Bank Albania** ndërmerr në ndihmë të shtresave në nevojë. Falë kësaj iniciative u mundësua shpërndarja e 250 pakove me ushqime për disa familje në Njësinë Bashkiake Nr. 6 në zonën e Kombinatit. Kësaj nisme iu bashkua edhe stafi i bankës duke gatuar racione ushqimore për familjet në nevojë.

Shoqata “Shqipëria” Vlorë, me mbështetjen e **OTP Bank Albania**, ofroi disa pako ushqimore për familjet në nevojë në qytetin e Vlorës.

UBA Bank

- Në vijim të mbështetjes së familjeve në nevojë, e kthyer në traditë për muajin e Ramazanit, banka shpërndau 350 kuti me ushqime familjeve myslimane në Shqipëri, kryesisht në Shkodër, Malësi e Madhe, Pukë, Elbasan, Librazhd, Kukës dhe Dibër.
- Lidhi një marrëveshje për mbështetje financiare për fëmijën e heroit Arian Sala, që u sakrifikuara për të shpëtuar jetën e kolegëve të tij, pas një shpërthimi zjarri të ndodhur në magazinën e një qendre tregtare në Tiranë.



OBJEKTIVI #3 Shëndeti i Mirë dhe Mirëqënie

Në mbështetje të institucioneve dhe projekte për komunitetin: rreth **16** milionë lekë.

MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

- Sigurimi dhe/ose mbledhja e fondeve për investime për institucionet shëndetësore.
- Shqyrtimi i hartimit të politikave që përfshijnë shërbime të transfertave të parasë nëpërmjet telefonit celular për transferimin efektiv të fondeve me qëllim mbulimin e kostove shtesë që lidhen me kujdesin shëndetësor shtetëror.
- Vendosja e një bashkëpunimi me ofruesit e telefonisë celulare dhe organizatat komunitare për mbështetjen e aktiviteteve që promovojnë shëndetin, duke reduktuar numrin e kredive të papaguara dhe kërkesat për sigurim që lindin nga çështjet shëndetësore.
- Mbështetje ndaj punonjësve, familjeve, komuniteteve dhe kombeve të shëndetshme, duke siguruar ambiente të shëndetshme dhe të sigurta pune.

DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

Në mbështetje të punonjësve dhe familjeve të tyre në sigurimin privat të shëndetit

Bankat bashkëpunojnë me shoqëri të njohura të sigurimit privat dhe ofrojnë për punonjësit e tyre sigurimin shëndetësor dhe paketat vjetore të përfitimeve. Paketa ose karta sigurimi shëndetësor me kushte preferenciale i janë vënë në dispozicion edhe familjarëve të stafit, për zgjedhje sipas interesit. Produktet që i ofrohet punonjësve përfshijnë kontroll mjekësor diagnostikues vjetor si dhe mbulimin e shpenzimeve mjekësore përgjatë vitit sipas kontratave dhe kategorive përkatëse.

Banka Kombëtare Tregtare dhe **Credins Bank** kanë ndërmarrë fushata të herëpashershme incentivuese në lidhje me vaksinimin e stafit.





Intesa Sanpaolo Bank Albania

- Ndërmori një fushatë gjatë tetorit 2021, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë që ka diagnostikimi i hershëm dhe kontrolli rutinë për identifikimin dhe trajtimin në kohë të kancerit të gjirit. Fushata i drejtohej punonjëseve dhe klienteve femra duke realizuar një video, ku theksohet rëndësia e kontrolleve diagnostikuese për të parandaluar sëmundjen si dhe trajtimi i saj.
- Banka u angazhua për të përcjellë mesazhe sensibilizuese në kanalet zyrtare të bankës dhe tek i gjithë stafi, nëpërmjet email-it në ditët:
 - » 2 prill 2021, Dita Botërore e Ndërgjegjësimit për Autizmin.
 - » 10 tetor 2021, Dita Botërore e Shëndetit Mendor.
 - » 31 maji, Dita Botërore kundër Duhanit.

PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

Alpha Bank Albania

- Mbështeti Institutin e Shëndetit Mendor në Shkodër duke dhuruar pajisje elektrike për familjet në vështirësi financiare, pjesë e këtij instituti.
- Në spitalin “Xhavit Mara” të rrethit Mat u financua blerja e një pajisjeje të re laboratorike për analizat e gjakut.
- Spitalit të qytetit të Tepelenës “Përparim Tepelena” iu dha mbështetje në blerjen e pajisjeve të kondicionimit të ajrit për dhomën e marrjes së gjakut dhe mbajtjes së kiteve laboratorike.
- Në qytetin e Peshkopisë u mundësua rikonstrukcioni i dhomave të gjumit të kopshtit Nr. 2 si edhe blerja e mjeteve ndihmëse mësimore.

Banka Amerikane e Investimeve

- Për të pestin vit radhazi mbështet YWCA of Albania në nismat për ndërgjegjësimin dhe parandalimin e kancerit të gjirit. Nën moton “Fjongo rozë na kujton se zbulimi i hershëm i kancerit të gjirit na shpëton jetën”, YWCA çeli fushatën e 13 të saj, me ambasadore të kauzës soprano Ermonela Jaho. Në datën 15 tetor, banka, si sponsor platin, i është bashkuar ecjes simbolike të organizuar në qytetin e Tiranës.
- Mbështet World Vision Albania në programin “Tungjatjeta Jetë”, në ndihmë të fëmijëve me aftësi të kufizuara në bashkinë Lezhë dhe Njësitë Administrative Balldre, Blinisht, Dajç, Kallmet, Zejmen, Kolsh,




Shëngjin. Projekti synoi fuqizimin e shërbimeve terapeutike në banesë, nëpërmjet pajisjes me materiale didaktike, si mekanizma të rëndësishëm në zhvillimin psikologjik dhe fizik të fëmijëve.

- Bëhet pjesë e fushatës së ndërmarrë nga Fondacioni Global Shqiptar gjatë muajit qershor “Ndërtimi i së Ardhmes”. Kjo nisëm do të ofrojë mbështetje për gjashtë organizata jofitimprurëse të përzgjedhura, pjesë e shoqërisë civile, me në fokus programet për fëmijët dhe të rinjtë në Shqipëri. Banka ofroi mbështetje për Fondacionin Mirësia në pajisjen me syze optike për disa fëmijë jetimë në qytetet Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkodër, Korçë, Sarandë.

Banka Kombëtare Tregtare

- Mbështeti Qendrën Shëndetësore Malësi e Madhe për të rritur cilësinë e shërbimit dhe qasjen në sistemin elektronik shëndetësor duke hartuar protokollin mjekësor online si dhe duke botuar një format libri. Krijimi i një platforme të tillë komunikimi sjell mundësinë e komunikimit të drejtpërdrejtë nëpërmjet formatit elektronik me çdo pacient, duke përmirësuar cilësinë e shërbimit për rreth 5,000 pacientë.
- Sponsorizoi dhe dhuroi disa pajisje IT për përmirësimin e kushteve të punës në Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Fier.
- Mbështeti pjesërisht procesin e restaurimit të Institutit të Shëndetit Publik për të përmbushur kërkesat standarde për ofrimin e një shërbimi të mirë dhe të denjë për publikun.
- Në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës organizuan ceremoninë e inaugurimit të kopshtit për fëmijët e stafit të bankës. BKT është kompania e parë në Shqipëri që kujdeset për punonjësit e saj dhe brezat e rinj duke vënë në dispozicion kopshte për fëmijët e moshës 6 deri në 24 muaj. Me një kapacitet prej 30 fëmijësh, hapësirat e kopshtit janë të organizuara në dhoma ndenjeje, dhoma gjumi, mensa dhe dhoma argëtimi, të gjitha të projektuara dhe të dekoruara për të krijuar një atmosferë më të larmishme dhe më të ngrohtë për fëmijët e stafit.
- Inauguroi Fitness Center-in për punonjësit e saj në ambientet e reja në Selinë Qendrore. Qendra është e pajisur me 12 pajisje moderne stërvitore dhe dy tavolina ping-pong, me kapacitet për përdorim nga 14-16 punonjës në të njëjtën kohë.
- Stafi i BKT-së i bashkohet edicionit të pestë të “Maratonës së Tiranës”.





- Mbështeti nismën e bashkisë “Biçikletë në punë”. Qëllimi i saj është të promovojë biçikletën si një mjet udhëtimi ekologjik, që kursen energji dhe i shëndetshëm.

Credins Bank

- Përgjatë vitit 2021 rëndësi të veçantë i ka kushtuar aspektit shëndetësor. Të shumta në numër kanë qenë institucionet, si: qendra shëndetësore, spitale, drejtori spitalore, OSHKSH, FSDKSH, etj., të cilat janë mbështetur nga banka në përmirësimin e kushteve të tyre të punës.
- Në mbështetje të “Fondacioni i Fëmijëve Shqiptarë, Dominic Scaglione” në fund të vitit duke dhënë pako me dhurata për qendrën për zhvillimin e fëmijëve me probleme autike.
- U dhuruan 2,000 maska për Qendrën Shëndetësore Nr. 8.

Fibank Albania

- Financoi projektin e Qendrës Arsimore të qytetit të Fierit për pajisjen me kamera sigurie të 4 kopshteve të qytetit. Ky projekt është i rëndësishëm për mbarëvajtjen e punës dhe organizimin e mirë të monitorimit ditor në qendrat e kujdesit për fëmijët.
- Gjatë muajit tetor, Muaji i Ndërgjegjësimit për Kancerin e Gjirit, ekipi i Fibank IT zhvilloi një filtër në Instagram për të postuar dhe shpërndarë foto në të gjitha kanalet e mediave sociale nga stafi dhe klientët e bankës. Ky aktivitet ishte më shumë se një mënyrë për të mbledhur fonde për kërkimin e kancerit të gjirit.

Raiffeisen Bank Albania mbështeti:

- Edicionin e 5-të të Maratonës së Tiranës.
- Luftën kundër kancerit të gjirit. Banka u solidarizua në mbështetjen e kësaj kauze duke ndezur dritat rozë në Zyrat Qendrore gjatë gjithë muajit tetor.
- Aktivitetin sportiv “Talenti i lagjes mund të jesh ti!”, me qëllim promovimin e sportit në komunitet, jetesën e shëndetshme dhe përzgjedhjen e talenteve të reja. Ky aktivitet u mbajt më datat 23 - 27 gusht në disa lagje të Tiranës.
- Edicionin e 3-të të 1/2 Maratonës së vrapimit në Voskopojë, më 12 shtator 2021, si sponsor i përgjithshëm. Pjesë e kësaj maratone ishte dhe stafi i bankës.



OTP Bank Albania

- Dhuroi pajisje zyre për disa institucione shëndetësore dhe sociale në Krujë, Shkodër, Pogradec.
- Ishte pjesëmarrëse në edicionin e 5-të të "Tirana Marathon" organizuar nga Bashkia e Tiranës. Disa punonjës të bankës morën pjesë në garën prej 10 km.
- Sponsorizoi aktivitetin "Konferenca Kombëtare e Shkencave Mjekësore 8", i cili u organizua për të tetin vit radhazi, si pikë bashkimi e profesionistëve nga e gjithë Shqipëria.

Tirana Bank për të disatin vit ka qenë pranë fëmijëve në pavijonin e Onkohematologjisë, në Spitalin e Pediatrisë, Tiranë, të cilët e kanë të pamundur nga ana shëndetësore të festojnë si bashkëmoshatarët e tyre. Përfaqësues nga stafi i Tirana Bank ishin pranë tyre, ku shpërndanë dhurata të personalizuar dhe u krijuan momente të gëzuara.

Union Bank, në vijim të procesit të vaksinimit të popullsisë nga Covid 19, dhuroi për Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Durrës një frigorifer, i cili do të shërbejë për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e vaksinave.

UBA Bank dhuroi pajisje për Spitalin Rajonal të Shkodrës.

Dhurim vullnetar gjaku

Kjo nismë synon të motivojë individët që të dhurojnë gjak rregullisht në mënyrë vullnetare nëpërmjet bankave të mirë-organizuar për dhurimin e gjakut (Kryq i Kuq). Stafi i bankave me shumë përgjegjshmëri, nisur nga nevoja dhe misioni human, ka mbështetur këtë kauzë jetike duke zbatuar protokollin e caktuar në kushtet e situatës së pandemisë.

Alpha Bank Albania; Credins Bank; Banka Kombëtare Tregtare; Fibank Albania; Intesa Sanpaolo Bank Albania; Tirana Bank; Union Bank.



OBJEKTIVI #4 Arsim Cilësor

Financim i shpenzimeve të arsimit:

496 kredi të reja të dhëna në vlerën **603** milionë lekë.


Teprica e kredisë në fund të vitit 2021: **1.25** miliardë lekë

Rreth **42.6** milionë lekë kontribut nga bankat në projekte në mbështetje të institucioneve dhe komunitetit.

Nëpërmjet AAB-së, janë financuar **3.65** milionë lekë nga bankat për trajnimin e punonjësve të tyre.

MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

- Bashkëpunim me institucionet financiare dhe qeveritë për të rritur dhe/ose investuar në financimin novator për projektet e arsimit.
- Zgjerimi i qasjes dhe shfrytëzimi i kursimeve personale dhe produkteve të kredisë për t'u ardhur në ndihmë familjeve në lidhje me planifikimin dhe financimin e shpenzimeve të arsimit.
- Ofrimi i këshillimit për të rinjtë me aftësi të kufizuara dhe të rinjtë e marginalizuar për përmirësimin e rezultateve në mësim dhe qasja e industrisë në rrjetin e talenteve të larmishme, çka ofron modele thelbësore për përmirësimin e përfshirjes sociale.
- Rritja e ndjeshme e numrit të të rinjve dhe të rriturve me aftësi të caktuara, duke përfshirë aftësitë teknike dhe profesionale për punësim, punë të denjë dhe sipërmarrje.



DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

Java e Parasë, 22-28 mars 2021

Gjatë Javës së Parasë, Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB), në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë (BSH), me mbështetjen e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR), Agjencisë së Sigurimit të Depozitave (ASD) dhe partnerë të tjerë, organizuan veprimtari të ndryshme, në përputhje me rregullat kombëtare të sigurisë shëndetësore anti-COVID-19, me qëllimin e promovimit të përpjekjeve që synojnë përmirësimin e edukimit financiar të të rinjve.

“Kujdesu për veten, kujdesu për paratë e tua” ishte tema zyrtare e Javës së Parasë 2021. Kjo temë theksoi rëndësinë e krijimit të qëndrueshmërisë financiare dhe të qëndrimit të shëndetshëm, në kontekstin aktual.

Java e Parasë 2021 përfshiu në mënyrë aktive më shumë se 500 nxënës dhe studentë, nga më shumë se 130 shkolla, të të gjithë cikleve.

Banka Kombëtare Tregtare, në bashkëpunim me Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tiranës, nënshkruan një marrëveshje për mbështetjen e bursave gjatë praktikave profesionale për studentët e përzgjedhur për të ndjekur Akademinë “FinTech” në BKT, për t’i përgatitur ata me njohuri për tregun e punës.

Gjatë vitit 2021, **Credins Bank** investoi për implementimin e një sistemi për të mësuar online LMS, me qëllim që i gjithë stafi në Shqipëri të ketë mundësi të barabarta të ndjekë trajnime dhe kurse online. Banka ka ofruar si çdo vit mundësi të barabarta për të gjithë punonjësit për të kërkuar specializime në kurse ose programe master të ndryshme. Janë nënshkruar marrëveshje me disa nga institucionet më të rëndësishme të trajnimeve në vend (Lincoln Center, Austrian Institute of Excellence) për të siguruar mundësi dhe alternativa për edukimin e vazhdueshëm të stafit.

- » 7,244 ditë trajnimi
- » Më shumë se 900 punonjës të trajnuar
- » 84 tema të ndryshme trajnimi

Intesa Sanpaolo Bank Albania

- Në marrëveshje me Ambasadën Italiane dhe Ambasadën Gjermane, vijon certifikimin dhe garanton aftësinë financiare të studentëve ndaj fondeve të depozituara, si dhe siguron transferimin e fondeve nga studentët, sipas kushteve të paracaktuara nga ambasadat dhe banka.
 - » Ambasada Italiane gjatë vitit 2021: 149 llogari të reja.
 - » Ambasada Gjermane gjatë vitit 2021: 191 llogari të reja.
- Banka ofron paketa studentore, duke treguar kujdes të veçantë për këtë kategori. Për studentët miratohen terma preferenciale. Gjithashtu, vijon marrëveshjen me Universitetin Ecampus dhe Universitetin Epitech në ofrimin e normave preferenciale të interesit për të gjithë studentët e tyre.

Union Bank gjatë vitit 2021 prezantoi një paketë të dedikuar për fëmijët deri në moshën 17 vjeç, e cila ofron kartë debiti për fëmijë, si dhe llogari rrjedhëse, llogari kursimi apo depozitë me afat, dhe qasje në UB Online për kontrollin online në çdo kohë të veprimeve të llogarisë nga prindërit apo fëmija sipas zgjedhjes.

PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

Në 24 Qershor u organizua nga Partnerët Shqipëri për të dytën herë Ankandi i Dhurimit “Rrathë Dhurues 2021”.

Alpha Bank Albania mbështeti projektin e qendrës “Te Ura” që konsistonte në krijimin e këndeve të studimit në ambientet e shtëpisë të familjeve në vështirësi ekonomike.

Banka Amerikaneve e Investimeve ofroi mbështetje për dy prej iniciativave të prezantuara:

- » Iniciativa e parë do të synojë përmirësimin e jetës së 126 fëmijëve të komunitetit “Lana Bregas” në Tiranë, nëpërmjet ofrimit të një këndi lojërash të munguar, në përmbushje të së drejtës së tyre për t’u argëtuar dhe socializuar.
- » Iniciativa e dytë do të mundësojë për 15 familje në vështirësi ekonomike me nga 3-5 fëmijë në zonën e Tufinës në Tiranë, nga një kënd studimi në banesat e tyre dhe mjetet e duhura shkollore.

Alpha Bank Albania bashkëpunoi me World Vision Albania dhe mbështeti nismat e grupeve rinore Impact duke krijuar 12 hapësira të dedikuara në 12 shkolla në Tiranë, Kamëz, Durrës, Korçë, Librazhd, Shkodër, Dibër e Lezhë, ku nxënësit mund të kalojnë kohë me njeri-tjetrin përmes lojërave dhe terapisë së artit.

Banka Amerikaneve e Investimeve mbështeti nismën e ndërmarrë nga Kryqi i Kuq Shqiptar, për të dhuruar çanta shkollore, mjete mësimore dhe tableta për 50 fëmijë nga familje në nevojë të rrethinave të qytetit të Tiranës.

Banka Kombëtare Tregtare

- Mbështeti Drejtorinë Arsimore Vlorë, Shkollën 9 vjeçare “Seit Gaçi” Stjar, Delvinë, për përmirësimin e kushteve të punës në këtë institucion.
- Sponsorizoi blerjen e pajisjeve elektronike për përmirësimin e mësimin në Shkollën e Mesme Bujqësore “Rakip Kryeziu”, Fier.
- Me rastin e festave të fundvitit shpërndau dhurata për fëmijët e shkollave, kopshteve dhe çerdheve në Delvinë.
- Në kuadër të bashkëpunimit me Federatën Shqiptare të Basketbollit, për të mbështetur aktivitetet sportive, mbështeti institucionin për aktivitetin “3X3 Basket Tirana” që është një aktivitet i zhvilluar nga “Federata Shqiptare e Basketbollit” në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës.
- Bashkëpunoi me Institutin Yunus Emre dhe mbështeti një institucion arsimor në organizimin e një vep- rimitarie të veçantë për nxënësit e institucionit.

Credins Bank mbështeti:

- Organizimin e Konferencës Kombëtare të Shkencave Mjekësore, që përfshin 10 webinarë për mjekët klinikistë, 10 webinarë për farmacistët dhe 10-15 webinarë për mjekët stomatologë.
- Kopshte, shkolla në qytete si Burrel, Pogradec dhe Fushë-Krujë, me rastin e 1 Qershorit, ku dhuroi librin “Përrallat e Pitalushes”.
- Bibliotekën e Beratit “Vexhi Buharaja”, ku ka dhuruar libra.
- Shkollën “Mehmet Akifi”: ku dhuruan kompjuterë për të zhvilluar lëndën e informatikës.
- Tirana Inc, një program i cili mbledh bashkë studentë të disa universiteteve në Tiranë të cilët japin idetë e tyre inovative për startup-e në fusha e industri të shumta, e me partnerë ndërkombëtarë, si EU for Innovation, Preneurz Amsterdam si dhe GlZ.
- Uplift Western Balkans 2021: Edhe këtë vit Credins Bank një partnere kryesore dhe sponsorizoi “Aksel- eratorin Uplift Albania 2021”, për të gjitha aktivitetet e akselatorit, në mentorime, trajnime e suport ndaj

startup-eve e ideve te ndryshme inovative. Programi shtrihet në 3 vende të ndryshme: Shqipëri (host), Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut. Fokusi i projekteve është në Inovacion & Fin – Tech & Telco.

- Shkollën 9 vjeçare “Dëshmorët e Rinisë”, ku dhuroi vegla muzikore (violonçel, violinë, stol për piano) për nxënësit e talentuar të shkollës.
- “Leader for one day” nga “JA Albania”: ishim në mbështetje të një aktiviteti tepër të bukur, ku një studente e përzgjedhur si shumë studentë të tjerë nga shkolla e qytete të ndryshme, kreu praktikë pranë degës qendrore për një ditë.

Fibank Albania

- Nëpërmjet Ditës Ndërkombëtare të Vajzave në TIK, banka punon me partnerë për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të mbështetur edukimin teknologjik dhe trajnimin duke inkurajuar më shumë vajza dhe të reja që të ndjekin në mënyrë aktive karrierën e TIK në Fibank.
- “Kreuztanne” është një libër i shkruar nga Fate Velaj, i përkthyer në gjuhën bullgare nga Anton Pançev. Ky libër përmes sponsorizimit nga Fibank i prezantohet me sukses lexuesit bullgar.
- Në kuadër të 90-vjetorit të lindjes së Dritëro Agolli, Fondacioni “Dritëro Agolli” organizoi veprimtari të dedikuara kulturore dhe sociale të mbështetura nga FIBANK si sponsor i përgjithshëm. Gjithashtu, Fondacioni “Dritëro Agolli” botoi një libër të vajzës së tij, Elona Agolli, të quajtur “Një baladë për mua dhe babain tim”, i cili do të jetë i disponueshëm edhe në audio dhe në internet.

Intesa Sanpaolo Bank Albania

Aktivitetet e organizuara për Javën Globale të Parasë.

- **Orë mësimore të hapura online:** Drejtuesi i Auditimit të Brendshëm të Bankës organizoi mësim on line me studentët e Universitetit Europian të Tiranës me temën “Auditimi i brendshëm në sektorin bankar shqiptar”.
- **Video edukative në lidhje me edukimin financiar.** Banka përgatiti dhe shpërndau tre video në lidhje me aktivitetet e edukimit financiar përmes një platforme masive online, e cila përdoret edhe për klasa online, ACADEMIA.al. Përmbajtja e këtyre videove është frymëzuar nga Muzeu i Kursimit në Torino. Videot përmbanin informacion mbi Kursimet dhe Riciklimin:
 - » Fëmijët dhe Kursimet
 - » Varet nga ju!
 - » Waste Revival edhe fëmijët mund të riciklojnë
- **Seria e edukimit financiar.** Gjatë kësaj periudhe janë regjistruar gjithsej 19 video, të cilat janë transmetuar në kanalin televiziv A2CNN. Temat e videove kanë të bëjnë me përdorimin e kartës, të drejtat e klientit, transparencën, depozitat, llogaritë e kursimit, kreditë, llojet e ndryshme të kredive dhe karakteristikat e tyre. Teksti që përshkruan çdo produkt /shërbim bankar gjendet në faqen zyrtare të bankës, në sektorin “Bota jonë”.
- Në bashkëpunim me EESTEC Tirana organizuan për të tretin vit “Konkursin e TIK”. Gara u zhvillua në ambientet e TechSpace dhe morën pjesë 32 studentë dhe të rinj, të cilët përfunduan testet logjike dhe teknike në fusha të ndryshme të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK). Pjesëmarrësve që arritën pikët më të larta iu dha mundësia e një interviste për një pozicion pune në Departamentin e IT të bankës.

Raiffeisen Bank Albania

- Edukimi dhe orientimi i të rinjve drejt shërbimeve digjitale financiare dhe rritja e njohurive për çështjet e sigurisë së informacionit ishin fokusi i 5 trajnimeve të para të realizuara nga Qendra WIT Albania me

mbështetjen e Raiffeisen. Gjatë projektit “Edukimi Financiar në Epokën Digjitale” u trajnuan rreth 200 nxënës të shkollave “Eqrem Çabej”, “Bajram Curri” dhe “Gjon Buzuku” në kryeqytet.

- Banka ishte e pranishme në Panairin e 8-të të karrierës të Universitetit EPOKA, ku studentët e shumtë u informuan për programet që banka ofron për studentët, si dhe avantazhet e Key Academy.
- Mundësoi 150 bursa 6-mujore studimi falas në qendrën inovatore për teknologji krijuese TUMO Tirana.
- Ka bërë të mundur pajisjen me 165 krevate për të vegjlit që frekuentojnë Kopshtin Nr. 1 në qytetin e Kukësit.
- Mbështeti projektin e qendrës studentore “ABC” Tirana Club “Apliko pagesën elektronike”, i cili vjen si edicion i tretë i programit mbi edukimin ekonomik dhe financiar të publikut.
- Ofron një paketë të dedikuar me produkte dhe shërbime preferenciale për të gjithë studentët, të cilës i përkasin moshës 18-25 vjeç dhe janë të pajisur me kartën e studentit.
- Në datat 6-8 dhjetor, në bashkëpunim me Autoritetin Kombëtar për Çertifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, mbështeti #CyberCampAlbania. Të rinjtë pjesëmarrës u njohën edhe me programin studentor Key Academy që Raiffeisen Bank ofron për studentët si dhe u informuan mbi aspektet e sigurisë në internet nga përfaqësues të bankës.
- Të njohim më shumë bankën, produktet dhe shërbimet e saj! Ky është qëllimi i Edubanking, i cili mundësohet nga Raiffeisen Bank. Në çdo seri videosh shpjegohen sa më thjesht terma dhe procese bankare.
- Së bashke me fondacionin Stepic CEE Charity mbështeti projektin e Caritas Albania “Fëmijët dhe të rinjtë në Shqipëri”, cili zbatohet në dy qytete: Tiranë dhe Cërrik (në zonën e Breglumit-Babru dhe Malasen-Cërrik) dhe është i orientuar drejt përmirësimit të jetesës së fëmijëve dhe të rinjve nga shtresat e marginalizuara dhe mbi të gjitha në edukimin dhe integrimin e tyre në shoqëri.
- Me rastin e 20 nëntorit - Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Fëmijëve - në qendrën ditore “Dritarja e Dijes”, e cila mbështetet nga fondacioni Stepic CEE Charity, u organizuan disa aktivitete me fëmijët e kësaj qendre.
- Me rastin e festave të fundviti Raiffeisen iu gjendet pranë fëmijëve të Institutit të Nxënësve që nuk shikojnë në Tiranë, ku u dhuruan pajisje kompjuterike. Banka, në dy vitet e fundit, ka siguruar fjalën e fundit të mjeteve të teknologjisë asistive për këtë komunitet nxënësish, me qëllimin për t’i ofruar një mjedis studimi të pavarur.

OTP Bank Albania

- Në mbështetje të artit dhe edukimit të fëmijëve për përçafimin e tij, OTP Bank Albania mbështeti një projektin 4-ditor “Punishtja e Elfëve”, i cili edukon fëmijët nëpërmjet teatrit.
- “Mashtresit financiarë, nga Ponzi...te Madoff” nga Adrian Civici është libri i cili doli në treg me



mbështetjen e Bankës. Ky libër është rezultat i një pune disaveçare të autorit dhe sjell për lexuesin historitë e skemave më të mëdha piramidale botërore, dhe jo vetëm.

- Për të qenë më afër zhvillimit të talenteve të reja, banka dhuroi një piano, instrument i cili ishte shumë i nevojshëm për ecurinë e talenteve të vegjël të shkollës “Jeronim de Rada”. Falë programit “Dhuro Kulturë” nga fondacioni “Arte”, banka besoi në madhështinë që nxënësit e shkollës mund të arrijnë nëpërmjet tingujve.
- Sponsor i panairit online të librit. Në mbështetje të lexuesve, OTP Bank Albania vendosi të japë kontributin e saj për promovimin online të librit. Të gjithë dashamirësit e librit e ndoqën të gjithë panairin nëpërmjet platformave virtuale.
- Sponsorizoi organizimin e aktivitetit Start-up City, në edicionin e tij të tretë, i cili u organizua në bashkëpunim me Universitetin Metropolitan Tirana. Aktiviteti u monitorua nga pedagogë dhe individë profesionistë të fushave të ndryshme, të cilët përzgjedhën idetë më të mira, duke bërë të mundur zhvillimin e tyre të mëtejshëm në treg.

ProCredit Bank

- Mundësoi vizitën e nxënësve të klasës së gjashtë të shkollës publike Edit Durham në muzeun Arkeologjik të Korçës.
- Në vijim të serisë së aktiviteteve që u zhvilluan në Muzeun Arkeologjik të Korçës, edhe punonjës të bankës ProCredit kaluan një të shtunë së bashku dhe vizituan këtë muze. Studimi i historisë vlerësohet nga Grupi ProCredit si një nga faktorët më të rëndësishëm që zhvillon mendimin kritik dhe njohuritë e përgjithshme të individëve. Trajtimi i temave mbi historinë dhe kulturën janë pjesë e rëndësishme e trajnimeve të ndjekura nga stafi i bankës.
- Përfaqësues të bankës dhanë një orë leksion të hapur për nxënësit e Shkollës Jopublike Kristaq Rama në Tiranë. Gjithashtu, nxënësve iu dhuruan edhe libra rreth qytetërimit të hershëm evropian për të zgjeruar më tej njohuritë e tyre.
- Think Tech është një ngjarje unike e cila fokusohet në zhvillimin e të rinjve, nismat e partnerëve, si dhe trajnime dhe këshilla profesionale në tregun vendas. Banka u përfaqësua në këtë konferencë duke treguar rrugëtimin digjital të saj dhe risitë që janë sjellë në treg në këtë kuadër.

Tirana Bank kontribuoi për Shkollën 9-vjecare “5 Dëshmorët” në Ksamil, duke krijuar kushte optimale për ndjekjen e mësimin për 540 nxënësit e kësaj shkolle, e pranishme në aktivitet edhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave znj. Anila Denaj.

UBA Bank, në bashkëpunim me Universitetin “AL Bukhary” në Malajzi, mundësoi bursa studimi për fëmijët e familjeve në nevojë.



OBJEKTIVI #5 Barazi Gjinore

Kredi për SME që drejtohen nga gratë:

551 kredi të reja të dhëna në vlerën **3.15** miliardë lekë.

Teprica e kredisë në fund të vitit 2021: **6.51** miliardë lekë.

Në fund të vitit 2021, bankat kishin **6,576** punonjës, nga të cilët **3,545** të gjinisë femërore. Numri total i punonjësve në borde dhe role drejtuese **2,309** nga të cilët **616** ishin femra.

Rreth **70** mijë lekë kontribut nga bankat në mbështetje të institucioneve dhe komunitetit.

MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

- Përshtatja e proceseve të kredisë dhe metodave të huadhënies për të zgjeruar dhënien e kredive për NVM-të e drejtuara nga gratë, për shembull, duke ofruar kredi pa kolateral.
- Britja e përqindjes së grave në bordet e shoqërive dhe rolet drejtuese, dhe investimi në politika dhe programe në mbështetje të grave si fuqi punëtore, si dhe nxitja e organizatave në zinxhirin e vlerave për ndërmarrjen e nismave të ngjashme.





DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

Credins Bank organizon trajnime të vazhdueshme, mundëson pjesëmarrjen e femrave drejtuese të bankës në aktivitete të ndryshme, punësimin e tyre si pedagoge, promovimin e vazhdueshëm të femrave drejtuese në aktivitete, etj.

Në **Fibank Albania** çdo vit, 8 Marsi është një ditë e veçantë për gratë dhe vajzat. Por nuk mjafton vetëm një ditë për të treguar mbështetjen. 72% e punonjësve janë gra dhe konsiderohen si arkitekthe të shoqërisë duke filluar nga krijimi i familjes, kujdesi për edukimin e fëmijëve dhe kontributi i tyre në çdo sektor ku punojnë.

Intesa Sanpaolo Bank Albania

- U bashkua me fushatën e UN Women Albania, “Ngjyrosni botën me ngjyrë portokalli: FUNDI I DHUNËS NDAJ GRAVE TANI!”, për strategjitë, programet dhe burimet për parandalimin dhe eliminimin e 16-të ditëve të aktivizmit kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave.
- Mbështet Programin e Grave në Biznes në Ballkanin Perëndimor, i cili promovon pjesëmarrjen e grave në biznes, duke ndihmuar ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) të drejtuar nga gratë. Financime afatshkurtra dhe afatmesme u ofruan për klientë të NVM-ve për të mbuluar nevojat e tyre për projekte investimi, si dhe për të mbuluar nevojat e tyre për shpenzimet operative të nevojshme në biznesin e përditshëm.

Programe dhe politika që aplikon Intesa Sanpaolo Bank Albania të cilat synojnë mbështetjen e gjinisë femërore:

- » Në të gjitha komisionet e bankës përfaqësimi i grave është 48%. Gratë përfaqësojnë shumicën në tre nga komitetet më të rëndësishme të menaxhimit të ISBA, si EXCO, Komiteti i Kredive dhe Komiteti i IA (përkatësisht: 57,1% në EXCO; 60% në Komitetin IA dhe 60% në Komitetin e Kredisë).
- » Në të gjitha komitetet e jashtme (AAB - Shoqata Shqiptare e Bankave, ICC - Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë, Dhoma Amerikane - Dhoma e Tregtisë Amerikane), përfaqësimi i grave në ISBA është 79%.
- » Për nënat që ushqejnë me gji parashikohet leje me pagesë në orare të ndryshme gjatë ditës pas kthimit të tyre nga leja e lindjes.
- » Ofron përfitime të zgjeruara të kujdesit shëndetësor për të gjithë punonjësit, që shkojnë përtej kërkesave të legjislacionit vendas, të përshtatura për gratë dhe burrat.
- » Duke filluar nga viti 2018 e në vazhdim, banka rimbursos koston e librave të studimit të fëmijëve për nënat beqare.
- » Kontribuon në zhvillimin profesional të ekipit femëror duke mbështetur financiarisht tarifat e anëtarësimin në organizatat profesionale (d.m.th. Shoqata e Avokatëve, Instituti i Audituesve të Brendshëm, etj.)
- » Qasje preferenciale në Smart Working për gratë që kthehen nga leja e lindjes. ISBA ka ofruar laptopë të dedikuar për këtë kategori punonjësish.
- » Më 22 prill 2021 (Dita Ndërkombëtare e Vajzave në TIK), ISBA përgatiti një video të shkurtër për të prezantuar një nga një të gjitha koleget gra që punojnë në këtë Divizion.

PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

Banka Amerikane e Investimeve në vijim të mbështetjes së organizatave që promovojnë barazinë gjinore, ka mbështetur “Strehëzën për Gra dhe Vajza” në Tiranë. Projekti synoi përmirësimin e mjediseve fizike dhe pajisjen me materiale për terapi arti, për të garantuar një cilësi shërbimi më të mirë, për gratë dhe

fëmijët e tyre, viktime të dhunës në familje.

Tirana Bank një institucion ku 75% të stafit janë femra, tregon çdo ditë se njeh vlerën dhe rëndësinë e gruas, por nuk ndalet këtu. Në 8 Mars, banka zgjodhi të ofrojë një mundësi më të mirë për një grua dhe një nënë, të drejtat e së cilës janë shkelur. Tirana Bank, vlerësoi bashkëpunimin me Albanian Woman's Empowerment Network, (AWEN), organizatë jo fitimprurëse, e themeluar në vitin 2009 dhe me një rrjet prej 9 organizatash lokale të shtrira në të gjithë Shqipërinë. Ky bashkëpunim konsistoi në ofrimin e mundësive, për një nga rastet që AWEN ndjek lidhur me barazinë gjinore, mbrojtjen e të drejtave të grave dhe mbështetjen ndaj grave të dhunuara.

Mesazhi i përcjellë ishte: Me këtë qëllim fisnik, Tirana Bank:

- » Zgjodhi t'i thotë "PO" thirrjes për t'i siguruar një zonje një jetë më të mirë, shtëpia e së cilës u bë e pabanueshme nga tërmeti.
- » Zgjodhi t'i thotë "PO" kërkesës për ndihmë të një nëne të divorcuar dhe me fëmijë.
- » Zgjodhi t'i thotë "PO" nismës për t'i ofruar shërbime avokatie, për t'i rikthyer fëmijën e mitur, marrë padrejtësisht nën kujdestari nga ish bashkëshorti.
- » Tirana Bank, këtu për barazinë gjinore !
- » Tirana Bank, këtu për arsimin!

Union Bank, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Gruas, prezantoi në muajin mars një ofertë të posaçme për të gjitha gratë dhe vajzat, për të përfitur ulje në produkte dhe shërbime bankare të caktuara. Qëllimi i kësaj pakete të dedikuar ishte rritja e mëtejshme e mundësisë së qasjes së gjinisë femërore në kryerjen e veprimeve bankare. Të gjitha klienteve vajza dhe gra që vizituan degët Union Bank gjatë ditës së 8 Marsit, iu dhurua nga një lule nga stafi në shenjë mirënjohjeje dhe respekti ndaj tyre.



OBJEKTIVI #7 Energji e përbalueshme dhe e pastër

Hua për energjinë e rinovueshme:

162 hua të reja të dhëna në 2021, në vlerën **13.62** miliardë lekë.

Teprica e kredisë në fund të vitit 2021: **41.61** miliardë lekë.

.....

MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

- Aplikimi i ekspertizës financiare ndaj modeleve të çmimit të energjisë, të cilat përbushin tre objektivat e qëndrueshmërisë financiare, efikasitetit të energjisë dhe çasje universale, duke përfshirë veçanërisht shqyrtimin e nevojave për energji të komuniteteve me të ardhura të ulëta.
- Nënvizimi i zhvillimeve në fushën e energjisë së rinovueshme, si për shembull impiantet me erë dhe impi-



Sigurimi i lidhjes me energji të përballueshme, të sigurt, të qëndrueshme dhe moderne për të gjithë.

antet fotovoltaike me energji diellore, për të përshpejtuar kalimin drejt një ekonomie gjithëpërfshirëse me nivel të ulët karboni.

- Sigurimi i lidhjes me energji të përballueshme, të sigurt dhe me shërbime moderne të energjisë, rritja në mënyrë të ndjeshme e pjesës së energjisë së rinovueshme në kombinimin e energjisë së botës, dhe dyfishimi i normës globale për përmirësimin e eficiencës së energjisë.

DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

Credins Bank kujdeset për kursim të energjisë nëpërmjet sistemit të brendshëm, i cili lejon optimizim të energjisë sipas përdorimit të saj.

OTP Bank Albania ka vënë në dispozicion kredinë GEFF për një numër të madh familjesh duke kontribuar kështu në suksesin e përgjithshëm të programit GEFF në Ballkanin Perëndimor. Në kuadër të këtij programi dhe për të vlerësuar të gjitha përpjekjet e stafit, çmimi nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) është dhurimi i 20 pemëve dhe mbjellja e tyre në të gjithë Ballkanin Perëndimor në emër të OTP Albania. Pemët do të jenë një trashëgimi e qëndrueshme për brezat e rinj dhe një shtysë për Bankën OTP Albania në misionin e saj për promovimin e eficiencës së energjisë.

ProCredit Bank, me qëllim realizimin e investimeve në panele fotovoltaike për prodhim energjie elektrike, ka nënshkruar një marrëveshje për financim të projekteve fotovoltaike me shoqërinë projektuese dhe zbatuese të tyre Vega Solar. Kjo marrëveshje rrit mundësitë që klientët e bankës të kryejnë investime në panele fotovoltaike, duke ndihmuar rritjen e evidencës për biznesin dhe mbrojtjen të mjedisit.



OBJEKTIVI #8 Punë dinjitoze dhe Rritje Ekonomike

Hua për SME me qëllim nxitjen dhe rritjen e qasjes në shërbimet bankare (pavarësisht degës së ekonomisë):

963 Hua të reja të dhëna në vlerën **22.11** miliardë lekë.

Teprica e kredisë në fund të vitit 2021: **39.58** miliardë lekë.

.....

Hua për turizmin /agroturizmin:

735 hua të reja të dhëna në vlerën **9.95** miliardë lekë.

Teprica e kredisë në fund të vitit 2021: **16.45** miliardë lekë.

.....

Rreth **10** milionë lekë kontribut nga bankat në mbështetje të institucioneve dhe projekteve për komunitet.

.....

MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

- Puna me aktorët kyç për gjetjen e zgjidhjeve praktike, të cilat do të ndryshojnë prirjen e bankave ndërkombëtare për tërheqjen e shërbimeve bankare përkatëse për shkak të kuadrit ligjor dhe rregullator.
- Zgjerimi i mikrofinancave (kursime, kredi dhe sigurime) për pronarët e bizneseve të vogla.



Nxitja e rritjes ekonomike të vazhdueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësim i plotë dhe produktiv dhe punë e denjë për të gjithë.

- Zgjerimi i financave për “shtresën me të ardhura të pamjaftueshme”, d.m.th. ndërmarrjet e vogla që lindin nga mikrofinanca, të cilat ende nuk janë në gjendje të marrin kredi nga sistemi bankar formal.
- Sigurimi i praktikave të synuara për të rinjtë me prejardhje nga shtresat e pafavorizuara, me qëllim nxitjen e lëvizshmërisë sociale, duke rritur gjithashtu performancën e shoqërisë përmes rritjes së shumëllojshmërisë së fuqisë punëtore.
- Fuqizimi i kapaciteteve të institucioneve financiare vendase për nxitjen dhe zgjerimin e qasjes në shërbimet bankare, të sigurimeve dhe financiare për të gjithë.

DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

Përmes një marrëveshjeje me Bankën Evropiane të Investimeve, **ProCredit Bank** mbështet bizneset e vogla dhe të mesme (NVM) dhe ndërmarrjet që kanë më pak se 3,000 punonjës (MidCaps), duke siguruar më tepër mundësi për financim me kosto më të ulët dhe me afate fleksibël ripagimi. Gjatë vitit 2021 nga ky fond janë mbështetur 74 projekte.

PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE


Alpha Bank Albania dhe **Credins Bank** mbështetën Tirana Economic Forum, një takim i nivelit të lartë me ndikim në politikë dhe biznes për të adresuar sfidat me të cilat përballet Shqipëria dhe bota.

Banka Kombëtare Tregtare, në mbështetje të nxitjes së punësimit, mori pjesë në Panairin Virtual të Punës dhe Aftësive 2021.

Raiffeisen Bank Albania, në bashkëpunim me Albania the Beautiful, për të dytin vit radhazi mbështet promovimin e Shqipërisë me ane të projektit “Albania Greets”. Urimet e fundit vitit erdhën nëpërmjet kartolinave me imazhet e destinacioneve më të bukura të disa qyteteve të Shqipërisë.

OTP Bank Albania

- Mbështeti panairin “Vizito Devollin”, i cili u zhvillua në muajin gusht në fshatin Ziçisht. U bë pikërisht përzgjedhja e këtij fshati si një ndër vendet me më tepër tradita dhe kulturë në zonën e Devollit. Me dashamirësinë e banorëve, me gatimet tradicionale dhe zakonet e tyre, panairi synoi të shndërronte fshatrat turistike të Devollit në destinacione kryesore turistike.
- Mbështeti Ditën Kombëtare të Vajit të Ullirit, e cila u organizua në datën 19 qershor në qytetin bregdetar të Vlorës. Në panair morën pjesë shoqëritë shqiptare të prodhimit të vajit të ullirit dhe nënprodukteve të tij nga Tirana, Elbasani, Vlora, Berati, Delvina dhe Lukova.



OBJEKTIVI #9 Industri, Inovacion dhe Infrastrukturë

Hua për sektorin e transportit; infrastrukturës së komunikimit:

506 hua të reja të dhëna në vlerën **3.29** miliardë lekë.

Teprica e kredisë në fund të vitit 2021: **4.14** miliardë lekë.


Rreth **50** milionë lekë kontribut nga bankat në investime si dhe në mbështetje të institucioneve dhe komunitetit.

MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

- Rritja e financimit afatgjatë për partneritetet publike-private në sektorin e transportit, energjisë së rinovueshme dhe infrastrukturës së komunikimit për të kontribuar në zhvillimin e tregtisë dhe qyteteve me aftësi ripërtëritëse.
- Sigurimi i investimeve në infrastrukturë në sferën e influencës përbën ndjeshmëri ndaj mjedisit dhe i përgjigjet nevojave të përdoruesve me të ardhura të ulëta, grave dhe grupeve të tjera të marginalizuara (përfshirë personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit).
- Rritja e qasjes së ndërmarrjeve të vogla industriale dhe ndërmarrjeve të tjera në shërbimet financiare, duke përfshirë kreditë e përballeshme dhe integrimin e tyre në zinxhirin e vlerave dhe në tregje.
- Përmirësimi i infrastrukturës dhe industrive rezervë për t'i bërë ato të qëndrueshme, me rritjen e efikasitetit të përdorimit të burimeve dhe adoptim më të gjerë të teknologjive të pastra dhe të shëndosha në aspektin mjedisor dhe të proceseve industriale, në pajtim me të gjitha vendet që veprojnë në përputhje me kapacitetet e tyre përkatëse.

DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

Fibank Albania ka investuar ndjeshëm në këtë fushë duke mundësuar një aplikacion të thjeshtë dhe të shpejtë Mobile, ka përmirësuar platformën e saj E-banking, ka prezantuar ATM të reja të teknologjisë së lartë që ofrojnë opsione të tërheqjes dhe depozitimit 24/7, ka prezantuar funksionin e saj të sigurisë 3D për të gjitha kartat, si dhe përmirësimet e sistemit për të ofruar zgjidhjen më të mirë digjitale për të gjithë.



Banka Kombëtare Tregtare

- Mbështeti institucionet që ofrojnë shërbim për komunitetin dhe dhuroi pajisje për mobilim zyre për përmirësimin e kushteve të punës për disa institucione, si: Agjencia Shtetërore e Kadastrës Vlorë; Reparti Ushtarak nr. 1001 Zall Herr; Bashkia Pustec.
- Mbështeti Ambasadën Shqiptare në Ankara dhe Konsullatën e Përgjithshme Shqiptare në Stamboll për organizimin e veprimtarive me rastin e festës së Pavarësisë Kombëtare të Shqipërisë.

Credins Bank si një partnere e institucioneve lokale, ofron mbështetje në nxitje të zhvillimit të vazhdueshëm duke dhuruar pajisje në përmirësimin e kushteve të punës dhe operacionale për të ofruar një shërbim sa më cilësor. Të shumta kanë qenë institucionet e mbështetura dhe gjatë vitit 2021:

- » Kryqi i Kuq, Dega Elbasan, Fier dhe Berat.
- » Komanda e Forcave Tokësore dhe Forcat Ajrore Shqiptare.
- » Zyra Vendore Arsimore Kamëz. Drejtoria Rajonale të Arsimit Para universitar Fier; Zyra Vendore Arsimore Tiranë (Shkolla 9-vjeçare “Lidhja e Prizrenit”).
- » Spitali “Shefqet Ndroqi”; Drejtoria e Shërbimeve Spitalore Universitare Njësia Vendore të Kujdesit Shëndetësor Gjirokastrë; Qendra Shëndetësore Golem, Qendra Shëndetësore Helmes, Qendra Shëndetësore Luz i Vogël; Qendra Shëndetësore Nr.1 Berat; Qendra Shëndetësore Kodër-Kamzë; Qendra Shëndetësore Nr. 6 Kombin; Njësia Vendore të Kujdesit Shëndetësor Lushnje.
- » Bashkia Shkodër, IEVP Vaqar, UKKA- Kavajë, OSHKSH Shkodër; Bashkia Kavajë-MZSH, ASHK Gjirokastrë, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi.
- » Qendra Komunitare Shkozë.
- » DRSHTRR Sarandë, Drejtoria Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Tiranë (DRSHTRR), Bashkia Kamëz.
- » Prokuroria Elbasan, Shtëpia e Pushimit (Ministria e Brendshme).

Credins Bank bashkëpunoi me Bashkinë Tiranë duke mbështetur me bursa 370 nxënës të moshës 12-18 vjeç, që vijnë nga familje me të ardhura të limituara, për të ndjekur programet e shumëllojshme që ofrohen në qendrën TUMO në Tiranë.

Intesa Sanpaolo Bank Albania, duke qenë se numri i shërbimeve dhe transaksioneve online është rritur, ka organizuar disa fushata sensibilizuese drejtuar punonjësve dhe publikut të gjerë mbi format e mashtimeve kibernetike me qëllim edukimin e publikut për këto çështje sensitive. Për më tepër, banka ka një nënfaqe të dedikuar posaçërisht për Sigurinë Kibernetike. Janë organizuar shumë trajnime të brendshme për punonjësit e bankës në lidhje me sigurinë kibernetike.

Është kthyer në një traditë tashmë mbështetja e ICT Awards, i cili startoi më datë 27 mars 2021 me edicionin e 9-të, nën mbështetjen e **Raiffeisen Bank Albania** si sponsor i përgjithshëm. Rrugëtimi i këtij edicioni arriti të tërhiqte 78 projekte, për të kulmuar në mbrëmjen e 11 qershorit me ndarjen e çmimeve.

Union Bank mbështeti edicionin e 5-të të “Albanian Cyber Academy” i cili u organizua nga Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK), me synimin e rritjes së kapaciteteve dhe thellimin e njohurive në fushën e sigurisë kibernetike për studentët e viteve të fundit të degëve TIK dhe operatorëve të infrastrukturave kritike të informacionit.

UBA Bank ka investuar në rebranding dhe krijimin e degëve të reja në Tiranë dhe në Durrës. Me një arkitekturë të re, bashkëkohore ofrohen kushte pune më të mira për punonjësit dhe një shërbim më cilësor për klientët.

OBJEKTIVI #10 Zvogëlim i Pabarazive

Rreth **4.6** milionë lekë mbështetje në ndihmë të shtresave në nevojë / personave me aftësi të kufizuara dhe kundër diskriminimit.

MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

- Përdorimi i teknologjive të reja, të tilla si shërbimet e pagesave nëpërmjet transfertave me celular për të krijuar modele operative dhe shpërndarëse më efikase dhe efektive për tregjet e reja, me qëllim zgjerimin e përfshirjes financiare.
- Zgjerimi i përdorimit të teknologjive të reja, të tilla si të dhënat me kapacitet të madh dhe informatika në renë kompjuterike “cloud” për të fituar njohuri të reja që përmirësojnë analizat e riskut dhe të mundësive.
- Sigurimi i mundësive të barabarta dhe reduktimi i pabarazive të rezultateve, duke përfshirë eliminimin e ligjeve, politikave dhe praktikave diskriminuese dhe promovimin e legjislacionit, politikave dhe masave të duhura në këtë drejtim.
- Përmirësimi i rregulloreve dhe monitorimi i tregjeve dhe institucioneve financiare globale dhe forcimi i zbatimit të këtyre rregulloreve. Lehtësimi i migrimit të drejtë, të sigurt, të rregullt dhe të përgjegjshëm dhe lëvizshmëria e njerëzve, përmes zbatimit të politikave të migracionit të planifikuara dhe të menaxhuara mirë.



DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

Intesa Sanpaolo Bank Albania si një nga bankat që ka nënshkruar marrëveshje me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për financimin e familjeve që përfitojnë nga programi qeveritar hua të buta me interes të subvencionuar, ofron këtë lloj kredie hipotekare me termat dhe kushtet më konkurruese.

Pagesat hyrëse “Express to Family”: Get Money to Family është një marrëveshje midis San Paolo IMI dhe Banca Italo Albanese, e caktuar për transfertë individuale në Euro, inicuar nga komuniteti shqiptar rezident në Itali për qëllime bamirësie ose arsye familjare (pagesat tregtare përjashtohen shprehimisht). Ky shërbim është operativ në të gjithë rrjetin e bankave të Grupit Intesa San Paolo IMI. Këto pagesa nuk kanë asnjë kosto, për të gjithë klientët që kanë një llogari rrjedhëse në bankë.

Banka organizoi edhe aktivitete të tjera sensibilizuese lidhur me diversitetin gjinor, kulturor dhe gjuhësor:

- » Më 1 mars 2021 (Dita e Zero Diskriminimit).
- » Më datën 16 maj 2021 (Dita Ndërkombëtare e të jetuarit së bashku në paqe).
- » Më 21 maj 2021 (Dita Botërore për Diversitetin Kulturor, Dialogun dhe Zhvillimin).
- » Më 20 qershor 2021 (Dita Botërore e Refugjatëve).
- » Më 17 tetor 2021 (Maratona e Tiranës 2021: Vraponi #WithRefugees, ku 22 punonjës të bankës morën pjesë).
- » Më 23 shtator 2021 (Dita Ndërkombëtare e Gjuhës së Shenjave).
- » Në 8 dhjetor (Dita Kombëtare e Rinisë), punonjësit e moshës 18-29 vjeç përbënin 27% të stafit të ISBA.
- » Më 20 dhjetor (Dita Ndërkombëtare e Solidaritetit Njerëzor).

Fondacioni Down Syndrome Albania nderoi Drejtorin e Përgjithshëm të **Fibank Albania**, z. Bozhidar Todorov në emër të Fibank me një certifikatë mirënjohjeje për të gjithë mbështetjen që banka i ka dhënë ndër vite këtij Fondacioni.

Raiffeisen Bank Albania ofroi pagesat dhe transfertat në kanalet digjitale në vlerë sa 1/2 e komisioneve në degë, me qëllim që klientët të shmangin pritjet e panevojshme, dhe të respektojnë distancimin social.

Tirana Bank, në bashkëpunim me Fondacionin Down Syndrome Albania, zhvilloi një strategji inovative me qëllim rritjen e fondeve të grumbulluara nëpërmjet blerjes së kartolinave të fundvitit të punuara nga ky grup fëmijësh, të cilat synojnë përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre.

Union Bank

- Ofron kritere të njëjta të huave dhe depozitave pa diferencime bazuar në të ardhura, gjini dhe raca. Ndërkohë, për kategori të veçanta, si pensionistë dhe minorenë/studentë, ofrohen çmime preferenciale për produktet kreditore dhe llogaritë rrjedhëse dhe të kursimit.
- Ndër mbështetësit kryesorë të aktivitetit “Të drejta të barabarta për mundësi të barabarta”, i cili u realizua nga shoqata “RESS-Egnatia” dhe Këshillit i Qarkut Elbasan. Ky aktivitet i organizuar për herë të parë në qytetin e Elbasanit, kishte në qendër të tij angazhimin e fëmijëve me çrregullim të spektrit autik (CSA) në aktivitete sociale dhe sportive.

OBJEKTIVI #11 Qytete dhe Komunitete të Qëndrueshme

Hua për shtëpi eficiente (përdorimi më i mirë i energjisë, izolimi, ngrohja, kur-simi i energjisë elektrike, etj.):

Mbi **580** hua të reja të dhëna në vlerën **14.28** miliardë lekë.

Teprica e kredisë në fund të vitit 2021: **18.47** miliardë lekë.

Investim në projekte në mbrojtje dhe ruajtje të trashëgimisë kulturore dhe natyrore në vlerë mbi **20** milionë lekë.

MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

- Vendosja e bashkëpunimit mes palëve të interesit në qytet për të analizuar dhe rritur rezistencën e sistemeve të ndërvarura, si për shembull infrastruktura e transportit dhe shërbimet komunale, të cilat përbëjnë themelet e rezistencës së aseteve individuale.
- Edukimi i pronarëve të shtëpive dhe bizneseve për materialet dhe teknikat e ndërtimit rezistente ndaj motit, dhe ofrimi i stimujve për zbatimin e tyre.
- Shpërndarja e informacionit për rrezikun, me qëllim informimin lidhur me legjislacionin e qeverisë mbi zonimin e tokës dhe kodet e ndërtimit në praktikë.
- Përforcimi i përpjekjeve për të mbrojtur dhe ruajtur trashëgiminë kulturore dhe natyrore të botës.
- Sigurimi i qasjes universale në hapësira të sigurta, gjithëpërfshirëse dhe të aksesueshme, të gjelbra dhe publike, veçanërisht për gratë dhe fëmijët, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara.

DREJTIMI PËRMEJ SHEMBUJVE

Banka Kombëtare Tregtare ofron Kredinë e Gjelbër, një produkt i cili mund t'i ofrohet të gjithë individëve që duan të investojnë në banesat e tyre, nëpërmjet projekteve që sigurojnë kursim energjie dhe reduktim të emetimeve të CO2. Kjo kredi mund të ofrohet si kredi me kolateral ose pa kolateral.

Credins Bank ka ndërmarrë mjaft nisma dhe projekte në drejtim të mbrojtjes së mjedisit, si: ndërtimi i stacioneve biçikletash në degët e bankës në të gjithë vendin, stacione biçikletash pranë QSUT dhe Spitalit të Traumës, etj.

*T'i bëjmë qytetet dhe vendbanimet njerëzore gjithëpërfshirëse,
të sigurt, rezistente dhe të qëndrueshme.*

Intesa Sanpaolo Bank Albania vijon projektin e filluar që nga viti 2015 për zbatimin e zgjidhjes së printimit të centralizuar, i cila zvogëlon përdorimin e letresë, CO2 dhe eliminon printerat dhe skanerat (të zëvendësuar me makina qendrore MFM-multifunksionale). Zyrat qendrore janë pajisur me ndriçim led dhe sigurohet një depërtim i mirë të dritës natyrale për kursim të energjisë.

PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

Alpha Bank Albania mbështeti krijimin e tregut të artizanëve i vendosur afër liqenit në qytetin e Pogradecit.

Banka Kombëtare Tregtare mbështeti Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI) në pajisjet e TI-së për të përmirësuar infrastrukturën e tyre IT, duke promovuar inovacionin teknologjik në këto institucione. Përmirësimi i shërbimit në institucionet që ofrojnë komunitet rrit efikasitetin e shërbimit për të gjithë aktorët, duke inkurajuar në këtë mënyrë zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien e komunitetit.

Raifeisen Bank Albania

- Më datë 18 maj, në Ditën Ndërkombëtare të Muzeve, Muzeu Historik Kombëtar prezantoi aplikacionin audio-guidë me mbështetjen e bankës.
- Ka bërë të mundur rehabilitimin e një prej shesheve në lagjen nr. 4 në Sarandë, duke e shndërruar atë në një park me standarde bashkëkohore.
- Mbështeti edicionin e parë të Check In Fest në 5 qytete: Shkodër, Gjirokastrë, Korçë, Vlorë dhe Tiranë.
- Mbështeti organizimin e edicionit të 8-të të Festivalit Mbarëkombëtar të Komedisë "KoKo Fest" në 29 gusht - 4 shtator në qytetin të Korçës.
- Mbështeti edicionin e 4-të të "South Outdoor Festival", një festival që ofron më shumë se 40 aktivitete të ndryshme në 3 - 6 shtator.
- Për të dytin vit me radhë mbështeti projektin "Babagyjshi sekret", duke bërë të lumtur dhe shumë fëmijë me dhurata me rastin e festave të fundviti.

ProCredit Bank ka sponsorizuar rinovimin e këndit të lojërave dhe gjelbërimin e parkut pranë qendrës komunitare në Shkozë duke mundësuar një ambient të organizuar mirë dhe me mundësi rekreacioni.

180 pemë frashër u mbollën në Tiranë, për një qytet më të gjelbër. Këto pemë u dhuruan nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), Bashkimi Evropian (BE) dhe Ambasada Austriake në Tiranë. **Union Bank** është partner i projektit GEFF që prej vitit 2018, duke ofruar Kredinë Kursim+ për klientët e saj, në sajë të së cilës ata përfitojnë një grant deri në 20% të shumës së kredisë, për përdorim të financimit për investime me efikasitet energjike. Ndaj këto pemë të mbjella ishin gjithashtu një shpërblim për Union Bank si bankë partnere në implementimin e këtij programi në Shqipëri.



OBJEKTIVI #12 Konsum dhe prodhim i përgjegjshëm

4.66 milionë lekë kontribut në menaxhimin e qëndrueshëm dhe përdorimin efikas të burimeve natyrore.

MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

- Zhvillimi i modeleve të reja për vendosjen e çmimeve për nxitjen e një jete më të qëndrueshme.
- Arritja e menaxhimit të qëndrueshëm dhe shfrytëzimit eficient të burimeve natyrore.
- Ulja në mënyrë të konsiderueshme e prodhimit të mbetjeve nëpërmjet parandalimit, reduktimit, riciklimit dhe ripërdorimit.
- Nxitja e shoqërive, veçanërisht shoqërive të mëdha dhe ndërkombëtare, për miratimin e praktikave të qëndrueshme dhe integrimin e informacionit që lidhet me qëndrueshmërinë në ciklin e tyre të raportimit.
- Sigurimi që njerëzit të kenë në çdo vend informacionin dhe sensibilizimin e duhur për zhvillimin e qëndrueshëm dhe mënyrën e jetesës, në harmoni me natyrën.

Credins Bank ka filluar të prodhojë çdo material marketingu me letër të riciklueshme. Logo e riciklimit është vendosur në materiale të ndryshme, si poster, fletëpalosje, agjendë, kalendar, etj.

Intesa Sanpaolo Bank Albania

Investoi në ristrukturimin e mjediseve të punës në zyrat dhe degën në Laprakë ku respektohen standardet e energjisë së gjelbër, interneti, tabletat, ndriçimi led, dhe OH&S (rampa, dalje emergjente, etj.).

Letër e certifikuar: eko-qëndrueshme (në kg)	16,608
Mbetje speciale jo të rrezikshme: letër dhe karbon (në kg)	6,000
Mbetje speciale jo të rrezikshme: shirita dhe film (në kg)	55
Mbetje speciale të rrezikshme: të tjera (në kg)	20
Mbetje speciale jo të rrezikshme: të tjera (në kg)	5,421
Mbetje speciale jo të rrezikshme: pajisje zyre (në kg)	480

Tirana Bank

Grumbullimi, asgjësimi dhe riciklimi i letrës në bankë, është një nga politikat më të rëndësishme për mbrojtjen e mjedisit dhe ndryshimeve klimatike. Janë kursyer:

- » 60,892 kg dru,
- » 804,204 litër ujë,
- » 140,751 kwh energji,
- » 4,041 kg CO2 (gjatë prodhimit).

OBJEKTIVI #13 Veprim për Klimën

Rreth **55** milionë lekë kontribut nga bankat në investimeve që ndikojnë pozitivisht në mjedis dhe në mbështetje të komunitetit.

MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

- Investime në – dhe/ose rritje të financimit për zbatimin e rrezikut klimatik, qëndrueshmërinë klimatike dhe adaptimin klimatik, duke përfshirë hua shtesë dhe instrumente të kapitalit.
- Marrja e masave për matjen, zvogëlimin dhe raportimin e ekspozimit klimatik dhe progresit të veprimeve ndaj ndryshimeve klimatike, me vijimin e rritjes së nivelit të transparencës dhe përputhshmërisë së raportimit në të gjithë sektorin e industrisë.
- Forcimi i qëndrueshmërisë dhe kapacitetit adaptues ndaj rreziqeve të lidhura me klimën dhe fatkeqësitë natyrore në të gjitha vendet. Integrimi i masave ndaj ndryshimeve klimatike në politika, strategji dhe planifikime kombëtare. Përmirësimi i edukimit, rritjes së ndërgjegjësimit dhe kapaciteteve njerëzore dhe institucionale, adaptimi, zvogëlimi i ndikimit dhe paralajmërimi i hershëm ndaj zbatjes së ndryshimeve klimatike.

DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

Alpha Bank Albania iu bashkua nismës globale “Ora e Tokës” e organizuar nga WWF.

Banka Amerikane e Investimeve aplikon zgjidhjet e menaxhimit të printimeve në zyrat qendrore dhe rrjetin e degëve të bankës, për uljen e volumit të përdorimit të letrës dhe asgjësimin e letrës nëpërmjet shoqërive të riciklimit.





Të gjithë produktet e kredive hipotekare parashikojnë sigurimin e kolateralit. Nëpërmjet licencës që **Credins Bank** ka si ndërmjetës në sigurime, ofron këshillim dhe mundësinë e aplikimit për polica te ndryshme sigurimi të gjithë klientëve. Klientët orientohen drejt sigurimit të pronave, jetës dhe shëndetit duke u asistuar nga eksperiencia e Credins në fushën e sigurimeve për përzgjedhjen e policës së duhur.

Intesa SanPaolo Bank Albania ka miratuar një rregullore ku nuk lejohet financimi i aktivitetit që prodhon karbon (fokus i veçantë në minierat e karbonit), dhe industrinë nxjerrëse të naftës. Bankës iu desh të tërhiqej gradualisht nga financimi tashmë ekzistues në sektorë të tillë.

Raiffeisen Bank Albania

- Në kuadër të 5 Qershorit, ditës Botërore të Mjedisit, stafi i bankës, në bashkëpunim me Korpusin Shqiptar të Vullnetarëve, pastruan plazhin dhe parkun e pishave të Zvërnecit. Ky ishte aksioni i tretë pas dy aksioneve të tjera të ndërmarra gjatë këtij vitin në plazhet publike në zonën Fshati Rinia në Durrës dhe plazhin e Velipojës. Falë këtyre aksioneve vullnetare është bërë e mundur pastrimi i 4 kilometrave vijë bregdetare prej nga u zhvendosën mbi 150 thasë me mbetje.
- Ndryshimi i klimës kryeson listën e shqetësimeve në mbarë globin, ndaj në mbështetje të kësaj kauze go-dina qendrore e bankës gjatë gjithë muajit nëntor ka qenë e ndriçuar në ngjyrë të gjelbër.

ProCredit Bank Albania

- Banka ka hequr nga qarkullimi çdo makinë me karburant, në përdorim të përditshëm të stafit të saj, duke i zëvendësuar me makina elektrike. Kjo initiative vjen në kuadër të politikave të brendshme të ProCredit Bank lidhur me implementim e masave për të ulur sa më shumë ndikimin negativ në mjedis.
- Për ta nxitur më shumë blerjen dhe përdorimin e makinave elektrike banka ka krijuar lehtësi në kuadër të infrastrukturës së karikimit, duke mundësuar 26 karikues elektrikë të dedikuar për karikimin e makinave elektrike të qytetarëve në të gjithë vendin. Energjia që do konsumohet në këto stacione do paguhet nga banka për 2 vitet në vijim, duke dhënë mundësinë që çdo drejtues makine elektrike të furnizojë me energji motorin elektrik gjatë kohës që mund të jetë në punë, apo orëve të natës, pa asnjë limit dhe kosto.
- Stafi i bankës ka ndërmarrë një initiative në mbështetje të komunitetit në Shkozë. Rreth 150 vullnetarë, staf dhe banorë të komunitetit përreth kanë marrë pjesë në aksion.



OBJEKTIVI #14 Jeta nën ujë

Hua për peshkimin (rritje e peshkut, mjete peshkimi, etj.):


33 hua të reja të dhëna në 2021 në vlerën **283** milionë lekë.

Teprica e kredisë në fund të vitit 2021: **2.98** miliardë lekë.

.....

MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

- Minimizimi dhe trajtimi i ndikimeve të acidifikimit të oqeanëve, duke përfshirë bashkëpunimin shkencor të të gjitha niveleve.
- Rregullimi në mënyrë efektive i mbledhjes së prodhimit dhe ndalimi i mbipeshkimit, peshkimit të paligjshëm, të pa raportuar dhe të parregulluar dhe praktikave shkatërruese të tij. Zbatimi i planeve të menaxhimit të bazuara në rezultate shkencore, në mënyrë që të ruhen rezervat e peshkut për një kohë sa më të shkurtër të mundshme, të paktën në nivelet që mund të prodhohet maksimumi i qëndrueshëm, siç përcaktohet nga karakteristikat e tyre biologjike.
- Ruajtja e të paktën 10 përqind të zonave bregdetare dhe detare, në përputhje me ligjet kombëtare dhe ndërkombëtare, të bazuara në informacionin më të mirë shkencor të disponueshëm.



OBJEKTIVI #15 Jeta në Stere

Financim për mbjellje:

24 hua të reja të dhëna në 2021 në vlerën **53** milionë lekë.

Teprica e kredisë në fund të vitit 2021: **103** milionë lekë.

Rreth **1.2** milionë lekë mbështetje ndaj institucioneve dhe komunitetit.

MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

- Përdorimi i metodave novatore financiare për të mbledhur fonde, me qëllim ruajtjen e pyjeve dhe ekosistemeve.
- Promovimi i ndarjes sa më të drejtë të përfitimeve që rrjedhin nga shfrytëzimi i burimeve gjenetike, dhe promovimi i aksesit së duhur në këto burime, në përputhje me standardet e vendosura dhe të miratuara në nivel ndërkombëtar.
- Mobilizimi i rezervave nga të gjitha burimet dhe nivelet, për të financuar administrimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe ofrimin e stimuljeve të mjaftueshëm për vendet në zhvillim, për përparimin e një administrimi të tillë, duke përfshirë ruajtjen dhe pyllëzimin.

DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

Bankës Kombëtare Tregtare mundësoi mbjelljen e pemëve në një rrugë të saponduar të Bashkisë Kamëz, nën iniciativën e Bashkisë "Pyllëzimi i Liqenit të Paskuqanit".

Credins Bank mbështeti Bashkitë: Kamëz, Tiranë dhe Fier ku u mbollën pemë në disa zona duke ndihmuar në mjedis dhe në përmirësimin e ajrit dhe ambientit.

Tirana Bank inauguroi projektin "Tarracat e Gjelbra" - një bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës.





OBJEKTIVI #17 Partneritet për Objektivat

Rreth **1.1** milionë lekë mbështetje ndaj institucioneve dhe komunitetit.

MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

- Forcimi i lidhjes mes krijimit të vlerave të korporatave dhe shoqërisë, dhe harmonizimi i strategjisë së krijimit të vlerës së organizatës me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.
- Pjesëmarrja në iniciativa me shumë palë interesi që përkrahin zhvillimin e qëndrueshëm.
- Zhvillimi i një sërë objektivash të industrisë së shërbimeve financiare të përafuara me OZhQ dhe harmonizimi i strategjisë së korporatave me ato objektiva, me qëllim optimizimin e kontributit në zhvillimin e qëndrueshëm.
- Bashkëpunimi me shoqëritë e tjera të shërbimeve financiare dhe palët e interesit për të ofruar perspektiva të industrisë për qeveritë, politikëbërësit, ligjvënësit dhe rregullatorët, mbi ndikimin e zhvillimit të qëndrueshëm të kuadrit ligjor, rregullator dhe tatimor, duke përfshirë rekomandimet për përmirësim.

DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

Banka Kombëtare Tregtare dhe **Credins Bank** janë anëtarësuar në UN Global Compact. Nëpërmjet këtij anëtarësimi bankat angazhohet të zbatojnë parimet e bazuara në 4 shtyllat kryesore: të drejtat e njeriut, punësimi, mjedisi dhe antikorrupsioni.

Alpha Bank Albania dha mbështetjen e saj në lidhje me organizimin e trajnimit virtual "Rruga drejt suksesit 2021". Të ardhurat nga ky aktivitet shkojnë në mbështetje të kauzave të ndryshme sociale.

Banka Kombëtare Tregtare mbështeti organizimin e takimit vjetor në fund të vitit të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Shqiptaro-Turke (ATTSO).





Credins Bank

- Në bashkëpunim me Partners Albania for Change and Development, mbështeti organizimin e “Konkursit të Bizneseve të Gjelbërta”. Qëllimi i këtij konkursi është prezantimi i ideve novatore për zhvillimin e një mjedisi të qëndrueshëm dhe konkurrues në treg duke promovuar gjithashtu edhe punësimin në Shqipëri.
- Mbështeti Konferencën Ndërkombëtare “Shaping the future: Digital Economy and recent technology trends”, organizuar nga Canadian Institute of Technology. Diskutimet vunë në dukje rëndësinë e madhe të teknologjisë dhe masat që duhen marrë nga vendet në zhvillim për të përmirësuar infrastrukturën digjitale, ulur kostot dhe ritur cilësinë.
- Mbështeti iniciativën e prezantuar në aktivitetin Rrathë Dhurues 2021, organizuar nga Partners Albania for Change and Development. Ndërtimi i një këndi lojërash në komunitetin “Lana Bregas”, në shërbim të më shumë se 100 fëmijëve të kësaj zone.

Raiffeisen Bank Albania

- Divizioni i Auditit të Brendshëm pranë bankës organizoi aktivitete në kuadër të muajit maj, muaji i nxitjes së profesionit të Auditimit të Brendshëm. Konkretisht:
 - » Pjesëmarrje në Kampionatin Evropian të Auditorëve të Brendshëm, ku u nderuan me çmime të para.
 - » Realizimin e dy spoteve /videove, ku prindër të stafit të Auditit të Brendshëm i shpjegojnë fëmijëve të tyre me fjalë të thjeshta rolin dhe profesionin e auditorëve të brendshëm brenda një organizate.
 - » Publikimi i një artikulli mbi “Mitet e rolit dhe funksionit të Auditit të Brendshëm”.
 - » Realizimi i 2 Podcast-eve me tema të përzgjedhura brenda komunitetit lokal të auditorëve të brendshëm, si për GDPR dhe 3-Linjat e Mbrojtjes.
 - » Realizimi i fotove me grupe – “Happy international internal audit month”, si edhe i një feste me stafin.
- Banka nënshkroi marrëveshjen e bashkëpunimit me UNFPA Albania duke konfirmuar angazhimin për zbatimin e politikave më miqësore ndaj familjes. Kjo do të arrihet përmes seancave konsultative, shkëmbimeve të eksperiencave dhe përvojës me zbatues të suksesshëm në rajon, e të tjera aktivitete që do të lehtësohen dhe mbështeten teknikisht dhe financiarisht nga ky projekt.

Union Bank organizoi seminarin me temë “Veprimtaria bankare dhe të drejtat e njeriut” me qëllim përmirësimin e proceseve brenda bankës. Ky seminar u zhvillua nga z. Ledi Bianku, Profesor në Universitetin e Strasburgut, në lidhje me aplikimin e të Drejtës Evropiane dhe Çështjeve të të Drejtave Themelore të Njeriut. Në fokus të seminarit ishin disa çështje relevante për sistemin bankar, si dhe për atë financiar, si dhe tema të lidhura me të drejtën e privatësisë apo të drejta të individit mbi pronën.



Rreth **78** milionë lekë mbështetje të veprimtarive në fushën e artit, kulturës dhe sportit.

Alpha Bank Albania

- Mundësoi publikimin e libërthit dhe CD-së “Ta dish”, projekt i baritonit të famshëm Gezim Myshketa, një përmbledhje këngësh tradicionale shqiptare, risjellë në një frymë moderne, por duke ruajtur gjithmonë me fanatizëm originalitetin e tyre.
- Mbështeti me bazë materiale ekipin e futbollit të qytetit të Pogradecit.

Banka Amerikane e Investimeve mbështeti:

- Aktivitetin “Shkodra Jazz and Swing”, mbajtur në datat 29-30 maj.
- Koncertin televiziv “Rock the dictator” nga Renis Gjoka.
- Produksionin kinematografik “Mbjellja e Pemëve”.
- Teatrin Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansambllit Popullor, si sponsor i përgjithshëm.
- Ndërtimin e fushave të tenisit në shkollën “Petro Nini Luarasi”.
- Enciklopedinë e autorit Ferid Hudhri “Shqipëria në Art”.
- Restaurimin e kishës së Shën Athanasit në Voskopojë.
- Klubin Sportiv “Studenti”, për të pestin vit radhazi.
- Koncertin recital nga Mariza Ikononi, “Mariza dhe Qyteti”, si sponsor i përgjithshëm.
- Festivalin Kulturor Shqipëri-Izrael si sponsor i përgjithshëm.
- Edicionin e 11-të të Festivalit Ballkanik të Filmit dhe Kulinarisë në Pogradec si sponsor i përgjithshëm.
- Festën e Birrës në Korçë, si sponsor i përgjithshëm.
- Lova Fest, si sponsor i përgjithshëm.
- Porto Palermo Festival nga Olen Çezari, si sponsor i përgjithshëm.

Credins Bank mbështeti:

- Shoqatën Kulturore VIZart në realizimin e aktivitetit “VIZart”.
- Shoqatën e Volejbollit Partizani në mbulimin e shpenzimeve për uniformat sportive të ekipit dhe shpenzime



të tjera gjatë kampionatit.

- Për të disatin vit rradhazi mbështet Aeronautikën Shqiptare, në aktivitetin e paragliding të Albania Open “Edicioni 22”.
- Shfaqjen teatrale “One Man Show” dhe standup comedy “Dielli lind andej nga perëndon” në teatrin eksperimental të Tiranës.
- “Albania Climbing Festival” për organizimin e një aktiviteti të sportit të climbing në Luginën e Valbonës.
- Mbrëmje poetike “Zoti e krijoi botën për dashuri”.
- Eventin “RedLipstick”, një projekt ku 12 gra të cilat kanë luftuar dhe janë përballur me sëmundjen e kancerit të gjirit janë bërë pjesë e një kalendari të veçantë duke u grmuar dhe fotografuar në çaste të lumtura.
- Festivalin “Krishtlindje në Tiranë”.
- Ekspozitën “Gravity forms of spiritual” nga artistja Anjeza Kolevica duke e transformuar Credins Bank në një ekspozitë qeramike dhe zyrat e degës qendrore në një ambient artistik e të këndshëm për syrin e çdo klienti.
- Federatën Shqiptare të Sportit (FSHSU) në aktivitetin e lojës së hendboll-it.
- Federatën Shqiptare të Sportit Shkollor, në botimin e librit “Të rritemi shëndetshëm”.
- Pop Art Festival, ku Arilena Ara performoi live albumin e saj më të ri muzikor tek Sheshi Skënderbej.
- Nona - Festa e Gjysheve Shqiptare, në Përmet.
- Koncertin live “AG Show”, të këngëtares Aurela Gaçe.
- MIK Festival, në Korçë & Prespë.
- “Festivalin Kulturor Shqipëri–Izrael”, në datat 12 – 21 shtator 2021 në Tiranë.
- Koncertin “Glykeria në Tiranë”, organizuar në datën 15 Shtator tek Amfiteatri i Tiranës.
- “INNVEST Summit 2021”, partner dhe sponsor kryesor.
- Maratonën “Këngë Moj”.

Raiffeisen Bank Albania mbështeti:

- Festivalin Mbarëkombëtar të Teatrit “Moisiu”-on, i cili u mbajt virtualisht në datat 23 shkurt-16 mars, si sponsor i përgjithshëm i Teatrit Kombëtar.
- Aktivitetin “Dritarja e shpresës”, një këtë spektakël artistiko-sportiv ku morën pjesë të rinj të grupmoshave 5 - 18 vjeç, të cilët treguan aftësitë e tyre në disiplinat e gjimnastradës.



- Festivalin e Shkollave të Mesme të Tiranës TK-RIN-ART, i cili u zhvillua në datat 24 - 26 maj. Në kuadër të programit “Edukimi mbi dhe përmes kulturës”, Teatri Kombëtar ngjiti në skenë 18 të rinj të talentuar dhe në këtë edicion u shpallën katër fitues.
- 20 vjetorin e koncertit “Tre Tenorët”, i cili u mbajt në datë 24 shtator në Amfiteatrin e Tiranës, si sponsor i përgjithshëm.
- Edicionin e dhjetë të festivalit “Jazz in Albania 2021”, në datat 16 –19 shtator në qytetet Tiranë, Fier dhe Korçë, si sponsor i përgjithshëm.
- Edicionin e pestë të festivalit Zâ Fest, në datat 29 - 31 korrik.
- Teatrin i kukullave “Pika e Ujit”, për fëmijët e 8 Qendrave Sociale në Tiranë. Teatri u mbajt edhe në dy qendrat sociale “Balonat” dhe “Dritarja e Dijes” të cilët mbështeten nga fondacioni Stepic CEE Charity. Përveç teatrit të kukullave, fëmijëve iu dhurua edhe libri “Udhëtimi i babagjyshit në qytetin e 1001 dritareve”.

OTP Bank Albania

- Katrori i Pushtetit, seriali shqiptar i dedikuar lirisë së medias dhe lirisë së shprehjes në vendin tonë. Banka ofroi ndihmën në realizimin e projektit.
- Mbështeti produksionin e serialit televiziv H.O.T, i cili i përket zhanrit dramë-komedi dhe trajtoi një histori me shumë dimensione duke adresuar fenomene sociale të kudogjendura.
- Sponsorizoi klubin e basketbollit “Partizani” (meshkuj). Qëllimi ishte realizimi i objektivave të skuadrës dhe përfaqësimi sa më dinjitoz në ndeshjet e ligës superiore gjatë zhvillimit të kalendarit sportiv të vitit 2021. Gjithsej u zhvilluan 15 ndeshje, nga të cilat 5 prej tyre ishin ndeshje për kupë për kategoritë A dhe B.

Union Bank mbështeti:

- Aktivitetin “Rinia, e ardhmja dhe shpresa”, i cili u organizua nga qendra “Gjenerata e re” në 4 dhjetor, si një maratonë performancash artistike me pjesëmarrje të grupeve të të rinjve dhe fëmijëve artistë, të shkollave të Tiranës dhe jashtë saj.
- Aktivitetin online show “MuzArt Tirana”, i cili u shfaq në datën 27 dhjetor në kanalin YouTube të balerinëve Enada & Gerd Vaso. Ky show virtual erdhi me tre performanca artistike në tre qendra të rëndësishme historike dhe kulturore të Tiranës: Muzeu Kombëtar, Muzeu Arkeologjik dhe Galeria COD (Qendra për Hapje dhe Dialog).
- Botimin e librit “Tinka Kurti, Ditari i një bashkëshorti” me autore Anila Mema. Ky projekt u realizua edhe me mbështetjen e Bashkisë Tiranë dhe Ministrisë së Kulturës.
- Kombëtaren Shqiptare të Futbollit. Edhe gjatë vitit 2021 ka vijuar mbështetjen e saj për Kombëtaren Shqiptare të Futbollit nën moton #Gjithmonë me Kombëtaren, si vazhdim i marrëveshjes me Federatën Shqiptare të Futbollit të rinovuar për periudhën 2020-2022.

